



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO


GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN
DEGA NË DRAGASH – OGRANAK U DRAGAŠU – DRAGASH BRANCH

C.nr.1/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DEGA NË DRAGASH, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtari Sabaheta Kurteshi me sekretaren juridike Senida Nuri – punëtore e kësaj gjykate, në çështjen juridike të paditësit N. K. nga fsh. Komuna e Dragashit, kundër të paditurve Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A. Prishtinë të cilën e përfaqëson S. Th. nga Prizreni, lidhur me kompensimin e diferencës së pagës, vlera e kontestit 3.866,79 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të dt. 07.07.2017, në prezencën e paditësit dhe në prezencën e përfaqësuesit të paditurës S. Th. morri këtë

A K T G J Y K I M



I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N. K. nga fsh. Komuna e Dragashit, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A. Prishtinë të cilën e përfaqëson S. Th. nga Prizreni që të më bëjë kompensimin e diferencës së pagës për pozitën time si përgjegjës dhe atë prej gradës 3 në gradën 6 që nga data 07.12.2010 deri me dt. 29.02.2012 dhe atë në emër të ndryshimit të pagës shumën prej 2.917,91 €, në emër të pjesës për Trustin Pensional – kompensimin për shumën e pa paguar për pension nga punëdhënësit 170.64,00 €, si dhe kompensimi për shumën e pa paguar për pension nga punëtori prej 170.64,00 €, si dhe kamatën e llogaritur në mjetet e pa paguara të ndryshimit të pagës në shumë prej 606.60 € e gjithsejtë në shumë prej 3.866,79 €, e deri në pagesën e plotë, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë në tërësi SI E PA BAZUAR.

II. Se cila palë mbanë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësi personalisht si dhe përmes të autorizuarit të tij L. B. ka parashtruar padi për kompensimin e diferencës së pagës, i personalisht në shqyrtimet kryesor dhe në fjalën e fundit ka mbetur pranë precizimit të kërkesëpadi së duke shtuar: se i njëjti është i punësuar pranë PTK-së si përgjegjës në pikën postare në fsh. [redacted], e qe janë shkelur të drejtat në punë se sepse nuk i është paguar paga prej datës 2.10.2007 deri me datë 01.03.2013 dhe atë diferencë e pagës për pozitën si përgjegjës dhe atë prej gradës 3 në gradën 6 dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia si e bazuar dhe paditësit ti kompensojnë diferencën e I propozon gjykatës që kërkesë padia e tij të aprovohet si e bazuar, mbetet pranë të dhënave në padi, pranë thënieve gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe provave të paraqitura. Gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe provave të paraqitura ndërsa sa i përket raportit mbi ndarjen e Postës nga PTK-ja me dt. 02.07.2012 ku edhe përfaqësuesi i të paditurës thekson se obligimet i bartë Posta e Kosovës, unë mbetem pranë padis dhe kërkesë padis se si e paditur është Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës – PTK-ja e jo si e paditur të paraqitet Posta e Kosovës. Në fjalën përfundimtare E precizoi kërkesë padinë ashtu që kërkojë nga e paditura që të më bëjë kompensimin e diferencës së pagës për pozitën time si përgjegjës dhe atë prej gradës 3 në gradën 6 që nga data 07.12.2010 deri me dt. 29.02.2012 dhe atë në emër të ndryshimit të pagesë shumë prej 2.917,91 €, në emër të pjesës për TRUSTIN Pensional – kompensimin për shumë e pa paguar për pension nga punëdhënësit 170.64,00 €, si dhe kompensimi për shumë e pa paguar për pension nga punëtori prej 170.64,00 €, si dhe kamatën e llogaritur në mjetet e pa paguara të ndryshimit të pagës në shumë prej 606.60 € e gjithsejtë në shumë prej 3.866,79 €, e deri në pagesën e plotë, duke theksuar se pranë të paditurës me kontratë pune është qe nga viti 2007 dhe atë me 02.10.2007 i cili i ka kryer punët e postierit e pastaj përgjegjësit të pikës shitëse në B. [redacted], ndërsa kompensohet si postierë me gradën 3, gjithashtu me datë 20.10.2012 ka lidhur me të paditurën kontratën e punës e protokolluar me nr. 012880-3131/2011 ku gjithashtu kompensohet si postier me gradën 3 edhe pse i kryejnë punët e përgjegjësit të pikës shitëse në B. [redacted]. Me datë 15.12.2009 ka pranuar vendimin pas parashtrimit të ankesës në komisionin e ankesave me të cilin vendim të komisionit është ndërruar titulli i vendit të punës nga postieri në përgjegjës të pikës shitëse e ku grada rapë ka mbet e njëjtë e të cilin vendim burime njerëzore të PTK-së deri me datë 08.12.2010 nuk e kanë zbatuar., dhe i njëjti nuk është paguar në fakt nuk i është paguar diferencë e pagës prej gradës 3 në gradën 6 ku dhe për vendin e punës përgjegjës në pikës shitëse parashihet grada 6, dhe për këtë konform nenit 79 të Ligjit të Punës kërkon qe të aprovohet padia dhe kërkesëpadia si e bazuar, Kërkoj shpenzimet dhe atë për taksën gjyqësor shumë prej 15,00 €, për Aktgjykim dhe Aktvendim shumë prej 60,00 €, për ekspertizën shumë prej 151,00 € gjithsejtë në shumë 226,00 €. Këtë kompensim të diferencës së pagës, kamatës dhe shpenzimeve të detyrohet e paditura Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

E paditura në përgjigje në padi gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe në fjalën e fundit ka deklaruar : e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë se paditësi ka lëshuar afatet ligjore brenda të cilave ka mundur të kërkojë mbrojtje e të drejtave të tij para gjykatës ashtu që këtu ka parashkrim absolut të padisë bazuar në dispozitat e ligjit mbi të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës Gazeta Zyrtare RSFJ-së nr. 60/89, 42/90 i aplikueshëm si Ligj në Kosovë dhe atë duke u

bazuar me nenin 79 dhe 83 të Ligjit në fjalë ku janë paraparë kushtet e mbrojtës së të drejtave të punëtorëve para organeve të gjykatës dhe organeve tjera. Në dispozitën e nenit 83 al. 1 të Ligjit thuhet "punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent në organizatë ose në qoftë se ky organ nuk merr vendim brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës përkatësisht të kundërshtimit ka të drejtë që në afatin e ardhshëm prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente. Në padi paditësi kontratën e punës të datës 20.12.2012 i është për mirësuar titulli i vendit të punës nga vendi i punës postier në vendin e punës përgjegjës i zyrës postare por grada nuk i është për mirësuar, përkatësisht i ka mbetur grada 3 e jo si e kanë përgjegjësit tjerë të zyrave postare gradën 6, ndërsa në padi ka theksuar paditësi që nga data 02.10.2007 i kryen punët e përgjegjësit të pikës shitëse në B [REDACTED]. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është e pas afatëshme për arsye se komisioni i ankesave ka marr vendim lidhur me ankesën e paditësit me datë 15.12.2009, ndërsa padinë e ka ushtruar në gjykatë me datë 18.06.2012 e që kjo shihet dhe vërtetohet dhe nga vula e protokollit të gjykatës ku është pranuar padia, ashtu që paditësi ka lëshuar të gjithat afatet ligjore për të atakuar çfarë do vendimi pranë gjykatës. Gjithashtu e paditura në përgjigjen në padi dhe në fjalën e fundit e ka kundërshtuar kërkesëpadinë dhe për shkak se asnjë vendim që ka të bëjë ekskluzivisht me kërkesat e punëtorëve e që është nivelimi i gradave, sistemimi i punëtorëve në pozita tjera të punës, kompensimi të ardhurave personale në mënyrë retroaktive për disa vite siç është rasti dhe me paditësin nuk kanë mundur të jetë objekt shqyrtimit i komisionit të ankesave sepse ky komision mund të vendos lidhur me kur punëtori atakon ndo një akt individual juridik, vendim apo aktvendim me të cilin i është mohuar realizmi ndo një të drejtën të punëtorit. Sipas matricës së autorizimeve të te paditurës të gjitha pagesat jashtë shkallës së aprovuar të pagave janë në kompetencë ekskluzive të krye shefit ekzekutiv të te paditurës, e jo te komisionit të ankesave se nuk ka kur far kompetence lidhur me vendosjen për gradat e punëtorëve. Vendimi i komisionit të ankesave në të cilën thirrret paditësi nuk e ka fuqinë e titullit ekzekutiv, por është vetëm një vendim rekomandues, e që krye shefi ekzekutiv është dashur të merr vendim definitiv lidhur me aktimin e gradës së punëtorit këtu paditësit. Mbesim në tërësi pranë thënieve të mija gjatë shqyrtimeve gjyqësore, përgjigjes në padi dhe parashtresave të paraqitura gjatë shqyrtimeve gjyqësore me dt. 17.05.2017, kërkoj nga gjykata që kërkesë padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Nuk ka kërkuar shpenzimet.

Gjykata lidhur me këtë çështje ka vendosur duke marr parasysh vërejtjen e Gjykatës së Apelit të Kosovës – Aktvendimi AC.nr.601/2014 e dt. 27.12.2016.

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të plot dhe të drejtë gjendjen faktike të kësaj çështje juridike në shqyrtimin kryesor në procedurën e provave administroj provat dhe atë: është bërë shikimi dhe është lexuar kontrata e punës në kohë të pacaktuar e datës 24.10.2011, vendimi mbi ri sistemimin e punëtorit të datës 08.12.2010 me numër 016050, referencën për punëtorin këtu paditësin e datës 16.07.2009, vendimi i datës 15.12.2009 me numër 01-7321/09 vendim mbi aprovimin e ankesës së paditësit, lista e pagesave të muajit nëntor 2007, janar 2008, janar 2009, janar 2010, janar 2011, janar 2012 dhe shkurt 2012, Bëhet shikimi në Kontratën e punës në kohë të pacaktuar me nr. 01-2880-3131/2011 e dt. 20.10.2011, nr. 01-5-414/12 e dt. 20.07.2012, bëhet shikimi në kërkesë për lqim për ri sistemim që ka shenjën HR formë nr. 27 e dt. 07.12.2010, lexohet Referenca e dt. 16.07.2009, vendimi i PTK-së i dt. 15.12.2009 me nr. 01-7321/09, Lexohet Referenca e dt. 03.04.2017 me numër 03-999/17 të lëshuar nga Posta e Kosovës Sh.A, lexohet vërejtja e të paditurës Telekomit i Kosovës SH.A. të dt. 19.05.2017. Lexohet Raporti – Tarifat e PTK-së bashkangjitur raportit, Rekomandimi i dt. 26.06.2012 dhe atë nga faqja nr. 1-8. Bëhet leximi në Kontratën e punës me nr. 836 të dt.

20.03.2013. Bëhet leximi i Aktgjykimeve Ac.nr. 2505/2013 i dt. 07.04.2014, Aktgjykimi C.nr. 1153/12 të dt. 16.01.2013, Aktgjykimi Rev.nr. 266/2015 i dt. 09.07.2015, Aktgjykimi C.nr. 811/11 të dt. 22.04.2016, shkresën e dt. 18.05.2012 e paraqitur nga L. S. Organeve kompetente PTK-së. Bëhet shikimi dhe lexohet Ekspertiza financiarë e ekspertit A. G. e dt. 12.04.2017, janë dëgjuar dëshmitarët dhe atë: M. S. dhe R. Sh.

Gjykata pasi bëri shqyrtimin e së cilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet në tërësi pasi vërtetoi këtë gjendje faktike:

Në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura PTK – Kosovë – SH. A Prishtinë, ndërsa tani Posten e Kosoves .

Kontestuese ka mbete se padia a është e aftshme apo jo dhe a është e bazuar.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet së të paditurës për sa i për këtë afatesh mërisë së padisë dhe ka gjetur se nuk qëndron ky pretendim nga fakti se paditësi padinë e kanë dorëzuar në Gjykatën Komonale në Prizren me datë 18.06.2012 e e cila padi përmes parashtresës nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren i është dërguar Gjykatës Themelore dega në Dragash me 15.02.2013 e që në këtë rast padia shihet se është dorëzuar në gjykatë në afatit ligjor. Vendimi ku është aprovuar ankesa e punonjësit N. K. vendimi i komisionit të ankesave të PTK-së, këtu paditësit i është lëshuar me datë 15.12.2009, ndërsa paditësi për realizimin e të drejtave të veta që dalin nga ligji i punës me padi i është drejtuar Gjykatës Komonale në Prizren me datë 18.06.2012 e që do të thotë brenda afatit ligjor. Gjithashtu duke u bazuar në vendimin mbi ri sistemimin e punëtorit të datës 08.12.2010 e nënshkruar nga krye shefi ekzekutiv PTK Prishtinë si dhe nga ana e kontratës së punës për kohë të pacaktuar e datës 20.10.2011 me nr. 01-2880-3131/2011 e lidhur në mes të punëdhënësit PTK – Prishtinë dhe të punësuarit N. K. gjykata vërteton se paditësi për mbrojtjen e të drejtave të tija para gjykatës kompetente padinë e ka paraqitur me datë 18.06.2012 e që në këtë rast padia e paditësit është paraqitur brenda afatit ligjor.

Gjykata duke u mbështetur në nenin 87 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 Ligjii aplikueshëm në Kosovë paditësi nuk ka lëshuar afatin kohor ligjor për paraqitje të padisë , ngase në këtë kontest në fjalë ka të bëjë me pagesë të diferencës së pagës , e cila kërkesë bëme pjesë në kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, me çka në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 në mënyrë decisive thuhet afati i parashkrimit dhe kërkesa të tilla është 3 vite duke u referuar kontratës së re të punës të dt. 20.10.2011 ku paditësi caktohet në kryerjen e detyrave të punës përgjigjes i zyrës postare në fshatin [redacted] ku edhe i është caktuar dhe grada në lartësi të gradës 3- të koeficienti për realizimit e të ardhurave personale pasi që ka punuar tek e paditura në pozitën si më lart e të cilën kontratë paditësi me datës 24.10.2011 në Zyre të PTK-së në Prishtinë e ka nënshkruar me vullnet dhe pa kurrfarë vërejtje si dhe duke marr parasysh datën e paraqitjes së padisë dhe kërkesën për kompensimin e diferencës së pagës, TRUSTIT pensional dhe bonusit ku është kërkuar për periudhën prej dt. 07.12.2010 e deri me dt. 31.12.2012 si dhe vendimin e komisionit të ankesave të paditurës të dt. 15.12.2009, qartë rezultojn se kërkesa e paditësit nuk është e parashkruar pasi që paditësi ka zënë afatin kohor prej 3 vitesh të paraparë në dispozitën ligjore të nenit 87 të Ligjit të punës, andaj padia paditësit në rastin konkret është e afatshme dhe e lejueshme.

Nga provat të administruara gjykata ka gjetur se paditësi në cilësinë e punë marrësit dhe e paditura në cilësinë e punë dhënësit kanë lidh kontratë pune në kohë të pacaktuar për periudhën e punësimit - 01.12.2010 e cila kontratë ka hy në fuqi me dt. 01.06.2011 ku i punësuarit në këtë rast paditësi është caktuar në detyrat e punës përgjegjës i zyrës postare, në njësi e Postës së Kosovës – Regjioni Prizrenit me të cilin vendim i është caktuar dhe baza e të ardhurave personale mujore në lartësi të gradës 3 si pas vendimit të përkohshëm të Drejtorëve të PTK-së nr. 01-1630/05 të dt. 28.02.2005, së paku njëherë në muaj e cila nuk mund të jetë më pak se paga minimale (këtë e parasheh neni 5 i Kontratës).

E paditura PTK me dt. 08.12.2010 ka marr vendim mbi ri sistemimin e punëtorit e që mban numrin e protokollit 01-6050/2010 ku punëtori në këtë rast paditësi N [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] i cili ka qen i sistemuar në punë dhe detyrat e punës postier Prizren – PTK SH.A risistemohet në punën dhe detyrat e punës përgjegjës i zyrës postare, në njësi e Postës së Kosovës – Regjioni e Prizrenit dhe atë prej dt. 07.12.2010 duke ju caktuar dhe të ardhurat personale mujore baza në lartësi të gradës 3 e jo në lartësi të gradës 6. Ky vendim është si pjesë përbërëse e kontratës së punës së dt. 20.10.2011 me nr. 01-2880-3131/2011.

Nga referenca për punëtorin N [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] këtu paditësi e lëshuar nga ana e PTK-së, në Prizren gjykata vërteton se nga menaxheri regional i DSHD-së në Prizren është dhënë performanca për periudhën kohore qershor dhjetor 2008 si dhe pëlqimi për ri sistemimin e tij i nënshkruar nga ana e menaxherit regional i DSHD-së Prizren.

Nga vendimi ku aprovohet ankesa e punonjësit N [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] këtu paditësi vendim i marr nga ana e komisionit e ankesave nr. 01-7321/09 e dt. 15.12.2009 gjykata vërteton se N [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] është sistemuar në pozitën përgjegjës i pikës shitëse B [REDAKTUAR] –Regjioni i Prizrenit, mirëpo në këtë vendim nuk është cekur apo paraparë ndërrimi i gradës prej 3 në 6 në fakt nuk është bërë fjalë për gradën – të ardhurat personale të punëtorit ku ky komision i ankesave pas analizimit të gjendjes është pajtuar se punonjësi në këtë rast paditësi nuk është fajtor për situatën e krijuar dhe ka përfillur urdhrat e udhëheqësve të vet dhe ka kryer punët dhe detyrat e punës të pozitës në të cilën është sistemuar, gjegjësisht si përgjegjës në pikën shitëse në fsh. [REDAKTUAR].

Pasi që kemi të bëjmë me padinë për kompensimin e diferencës së pagës nga administrimi të gjithat provave së cilës veç e veç gjykata ka vërtetuar se këtu paditësi me datë 20.10.2011 ka nënshkruar me vullnet kontratën e punës për kohë të pacaktuar në vendin e punës përgjegjës i zyrës postare në fsh. [REDAKTUAR] ku i është caktuar dhe paga bazë për punën në lartësi të gradës 3 sipas vendimit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të PTK-së nr. 01-1630/05 të dt. 28.02.2005 (shih nenin 5 të kontratës) e që me asnjë provë tjetër të paraqitur dhe të administruar në këtë çështje civile paditësi nuk ka vërtetuar që i ka shtjer të gjitha mundësit e ankimit para organeve përkatëse të punëdhënësit lidhur me ndryshimin e gradës prej 3 në gradën 6.

Gjykata vërteton dhe vlerëson se kontrata e punës është në harmoni të plot me dispozitat ligjore të ligjit të punës neni 11 ku parashihet përmbajtja e kontratës së punës e që kjo kontratë duhet të përmban *“lartësinë e pagës bazë si dhe ndonjë shtete ose të ardhur tjetër – neni 11 pika 1”* e që në rastin konkret palët në kontratë neni 5 ka përcaktuar se të punësuarit – paditësit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punë dhënësit në lartësi të gradës 3.

Nga raporti mbi ndarjen e Postës nga PTK, me datë 02.07.2012, rezultoi si në raport, veç tjerash është përcaktuar edhe mënyra e transferimit të punonjësve të punëtorëve pas ndarjes së PTK-ës.

Nga ekspertiza e ekspertit aktruar A. G. [redacted] të datës 18.04.2017 gjykata konstatoi se për periudhën kohore nga data 01.12.2010) e deri me datë 28.02.2012, kur paditësi ka punuar në vendin e punës përgjegjës me gradën 3, dëmi që i është shkaktuar për shkak të mos realizimit të pagës në bazë të punës që ka kryer si përgjegjës i pikës postare në fshatin [redacted], e që sipas ti i takon gradës 6, në raport me vendin e punës kur ka punuar si postier i graduar sipas gradës 3, bashkë me kamatën dhe bo nuset tjera arrin në total shumën prej 3.866,79 euro.

Nga dëgjimi i dëshmitarëve M. [redacted] S. [redacted] dhe R. [redacted] S. [redacted], gjykata vërteton se paditësi vite me radhë ka punuar si postier por ka kryer dhe punët e përgjegjës të zyrës me ndërgjegjeje dhe disiplinë si dhe me njohuri profesionale. unë në Postën e B. [redacted] jam punësuar në vitin 2008 dhe aty e kam gjetur duke punuar N. [redacted] K. [redacted] i cili ka punuar të gjithat punët e Postës si postier dhe si përgjegjës.

Është dëgjuar dhe eksperti aktruar A. G. [redacted], i cili është deklaruar si në procesverbal duke mbete pran thënieve të shkruara në ekspertizë.

Nga vlerësimi i këtyre provave si më lartë gjykata vërtetoi se këtu paditësi nuk ka lidh ndonjë kontratë tjetër me PTK-ën në vendin e punës përgjegjës i zyrës ku është graduar me gradën 6. Gjithash këtu e paditura nuk ka marrë ndonjë vendim tjetër ku paditësi është sistemuar në vendin e punës përgjegjës ku është gradua me gradën 6.

Përkundrazi nga provat e administruara dhe atë të Kontratës për Punë për Kohë të caktuar e datës 20.10.2011 Nr. 01-2880-3131/2011 këtu me të paditurën si punëdhënëse dhe paditësit si punë marrës paditësi është caktuar në vendin e punës përgjegjës i zyrës Postare, në njësinë - Posta e Kosovës ku të punësuarit i është caktuar paga bazë, në lartësi të gradës 3 (shih nenin 5 të Kontratës) e të cilën kontratë paditësi e ka nënshkruar pa vërejtje, dhe nga kjo shihet se paditësi është pajtuar me kushtet e kontratës.

Ligji i punës në nenin 3 pika 1.11 përcakton se kontrata e punës është "akt individual e cila lidhet në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës". Nga vlerësimi i gjykatës kontrata është në harmoni me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës.

Lidhur me vendimin e komisionit të ankesave të PTK-ës (datë 15.12.2009), përmes të cilës i është aprovuar ankesa paditësit ku është vendosur që paditësi të sistemohet përgjegjës i zyrës Postare, njësia në Prizren, si referenca e menaxherit regional të Prizrenit te datës 16.09.2009, gjykata i ka marrë parasysh sepse nuk është kontestuese që paditësi është caktuar si përgjegjës i zyrës Postare, njësia Postare në Prizren.


Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave veç e veç ka vërtetuar dhe konstaton se padia – kërkesë padia e paditësit nuk është e bazuar me ligj dhe të njëjtën duhet refuzuar si të pa bazuar sepse këtu paditësi nuk arriti me asnjë provë të shkruar që të vërteton se i është caktuar grada 6 për punën si përgjegjës në zyrën postare në njësia në Prizren e pastaj i transferuar në pikën shitëse të Postës në B [REDACTED] Komuna e Dragashit. Paditës çdo vendim dhe çdo kontratë ka nënshkruar me vullnetin e ti të plotë dhe ka qenë i njoftuar me te drejtat dhe detyrimet që dalin nga kontrata.

Andaj gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesëpadinë për detyrimin e të paditurave që të kompensojnë diferencën e pagave dhe banuesve tjera si të pa bazë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në kuptim të dispozitave nga neni 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DEGA NË DRAGASH
C.nr.1/17 të dt. 07.07.2017

Sekretare Juridike:
Senida Nuri



Gjyqtari:
Sabaheta Kurteshi



UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës. Ankesa dërgohet nëpërmjet kësaj gjykate.